



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kalendari për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë BACHELOR, Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë. Viti Akademik 2020-2021

KREU IV/2		Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit
1.	Kreu IV/2, pika 1 Kandidatët nga Republika e Kosovës me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e komunitetit Rom dhe Egjiptian, aplikojnë pranë IAL-ve, në datat e përcaktuara, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL-të.	01.09.2020 – 18.09.2020
2.	Kreu IV/2, pika 2, fjalia 1 Kandidatët që aplikojnë në programe studimi për të cilat është parashikuar konkurs pranimi aplikojnë pranë IAL-ve respektive deri më datën e përcaktuar.	18.09.2020
3.	Kreu IV/2, pika 2, fjalia 3 Konkurset e pranimit zhvillohen në datat e përcaktuara.	21.09.2020
4.	Kreu IV/2, pika 9 IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre, si dhe për çdo program studimi që ofrojnë, ato publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën mënyrën e përzgjedhjes. Gjithashtu IAL-të në datën e përcaktuar, publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre elektronike zyrtare listën jo përfundimtare të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.	23.09.2020
5.	Kreu IV/2, pika 11 IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën e përcaktuar, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.	28.09.2020
6.	Kreu IV/2, pika 12 Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës së përcaktuar.	28.09.2020 -05.10.2020
7.	Kreu IV/2, pika 13 Pas datës së përcaktuar, sekretaritë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve, për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.	06.10.2020
8.	Kreu IV/2, pika 14 IAL-të brenda datës së përcaktuar, përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues sipas dokumenteve të dorëzuar në momentin e aplikimit.	12.10.2020
9.	Kreu IV/2, pika 15 IAL-të datës së përcaktuar, dërgojnë pranë QSHA-së listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format EXCEL me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin e tyre.	15.11.2020